



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS
AGJENCIA QENDRORE E VLERËSIMIT TË ARRITJEVE TË NXËNËSVE

PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2009

SESIONI I

(I DETYRUAR)

SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

VARIANTI B

Lënda: Letërsi dhe Gjuhë shqipe
Gjimnazi – drejtimi natyror

Udhëzime të përgjithshme:

- Testi përbëhet nga dy pjesë.
- Testi përmban një total prej 50 pikësh.
- Testi ka 25 pyetje. 13 me zgjedhje dhe 12 me zhvillim.
- Për pyetjet me zgjedhje përgjigja e saktë vlerësohet me 1 pikë.
- Për pyetjet me zhvillim përgjigjet konsiderohen orientuese dhe në skemë parashikohen variantet e mundësive të përgjigjeve të nxënësve. Për rastet kur përgjigja e nxënësit nuk përshtatet plotësisht me përgjigjen në skemë, por afron me logjikën e pyetjes, komisioni i vlerësimit është i detyruar të këshillohet me drejtuesin teknik dhe me specialistët e AVA, për të bërë vlerësimin përfundimtar.
- Vlerësimi i pyetjes *ese* është specifikuar me kujdes. Vlerësimi i saj do të bëhet duke pasur parasysh rubrikat në tabelën e vendosur në fund të pyetjes dhe që është posaçërisht për vlerësuesit e testit.
- Saktësia gjuhësore ndikon negativisht në vlerësimin e nxënësit, në ato raste, kur ka përsëritje të theksuar gabimesh ose gabime të cilat prishin në mënyrë të vazhdueshme kuptimin e shprehjes.

PJESA I**Ismail Kadare****Kinema e vjetër**

Pyetja 1	D	1 pikë
Pyetja 2	B	1 pikë
Pyetja 3	B	1 pikë
Pyetja 4	A	1 pikë
Pyetja 5	B	1 pikë
Pyetja 6	A	1 pikë
Pyetja 7	C	1 pikë

Pyetja 8 3 pikë

- a) varg i shkurtër: kinema e vjetër/ kinema e feminisë /s'shesin kikirikë/ ku në pushimet e seancave.
- b) varg i gjatë: ku prej kohësh më s'lozin filma të përsëritur/ku s'bëjnë më zhurmë njerëzit me karriget.
- c) vargu i shkurtër konstaton dhe thekson tipare, cilësi, veprim. Vargu i gjatë shtrin mendimin. Përdorimi i të dyve jep ritmin e brendshëm dhe e harmonizon atë me gjendjen shpirtërore të heroit lirik.

- **3 pikë**, nëse nxënësi jep dy shembujt dhe efektin që krijojnë.
- **2 pikë**, nëse jep një shembull bashkë me efektin.
- **1 pikë**, kur shkruan një shembull.
- **0 pikë**, kur jep përgjigje të gabuar ose ka mungesë përgjigjeje.

Pyetja 9 2 pikë

Shembujt në poezi janë: me arna ish republika, ne ishim me arna, Koha, bërrylat, shtetet ishin me arna.

- **2 pikë**, kur jep dy shembuj nga ato më lart..
- **1 pikë**, kur jep vetëm një shembull.
- **0 pikë**, kur i jep të gabuar ose asnjë përgjigje.

Pyetja 10 **2 pikë**

a) kinemaja

b) e vjetër, e braktisur, e shtrenjta, e rralla, e dashura.

- **2 pikë** nëse nxënësi gjen kinemanë dhe jep njërin nga mbiemrat.
- **1 pikë** nëse jep njërin nga të dy
- **0 pikë** nëse nuk jep asnjërin ose gjen mbiemra dhe fjalë në tekst që nuk kanë lidhje me pyetjen.

Pyetja 11 **2 pikë**

a) flet nga këndvështrimi i të rriturit.

b) raporti midis vendeve që autori ka parë dhe kinemasë është kontrastiv: sallat janë luksoze dhe të ndritshme, kinemaja është barakë e vjetër, e rrëmuishme. Ndërkohë ai më me bujë e kënaqësi ka hyrë te kinemaja.

- **2 pikë**, nëse gjen këndvështrimin dhe kontrastin.
- **1 pikë**, nëse nxënësi jep njërin nga ato.
- **0 pikë**, nëse përgjigja nuk përshtatet me kërkesat ose nuk jep asnjë përgjigje.

Pyetja 12 **8 pikë**

12a Shtjellimi i idesë 2 pikë. Duhet të kihen parasysh:

- Fokusimi në temë, përshtatja me qëllimin e temës.
- Të flasë mbi një objekt, ngjarje, njeri nga fëmijëria.
- Të tregojë lidhjen e veçantë që ka me të.
- Të përshkruajë arsyet pse e pëlqen atë dhe pse i ka mbetur në kujtesë.
- Të tregojë sesi e vlerëson sot, megjithëse ka kaluar shumë kohë.
- **2 pikë**, kur ka treguesit e mësipërm.
- **1 pikë**, kur trajton temën përkatëse, por nuk jep argumente të qarta në lidhje me të.
- **0 pikë**, kur nuk përshkruan asgjë, ose kur ajo që shkruan, nuk ka kuptim.

12b Organizimi dhe struktura 2 pikë. Duhet të kihen parasysh:

- Pjesët përbërëse (hyrje, zhvillim, mbyllje).
- Kronologjia (rend të mendimit dhe ideve, të shembujve që jep).
- Logjika (të ketë lidhje me çfarë është thënë më parë).
- Kalimet e kuptimshme (nga elementi i zgjedhur në ndikimet tek vetë personi që e tregon atë), etj.
- **2 pikë**, kur nxënësi i plotëson standardet e mësipërme.
- **1 pikë**, kur respekton vetëm strukturën formale, por nuk demonstron cilësi në ndërthurjen e saj me kuptimin.
- **0 pikë**, Kur struktura nuk të jep asnjë kuptim.

12c Stili dhe origjinaliteti. 2 pikë. Duhet të kihen parasysht:

- Shprehjet origjinale (figuracioni, fjalë jo të zhargonit të përditshëm).
 - Nëse stili është i gjallë, tërheqës, ndikues. (me rrjedhshmëri , të ketë efekt)
 - I qartë.
 - Jo imitues,(të mbështetet te autori, por të japë dhe mendimin e tij.
- **2 pikë**, kur ka treguesit e mësipërm.
 - **1 pikë**, kur thotë diçka të vetën, por pa larmi, pa bukuri, pa shumë qartësi.
 - **0 pikë**, kur nuk thotë asgjë, ose nuk kuptohet asgjë nga ajo që ka thënë.

12d Saktësia gjuhësore(sintaksa dhe drejtshkrimi) 2 pikë. Duhet të kihen parasysht:

- Trajta e duhur e fjalëve.
 - Fjali të sakta.
 - Shenjat e pikësimit.
 - Shkronja e madhe.
- **2 pikë**, kur nxënësi ka bërë një përshkrim brenda normave të mësipërme
 - **1 pikë**, kur ka gabime, por kuptohet se çfarë ka shkruar.
 - **0 pikë**, kur gabimet e shumta deformojnë, ose nuk lejojnë kuptimin e shprehjes.

Pjesa II**Abert Kamy****I huaji****Pyetja 13 C 1 pikë****Pyetja 14 A 1 pikë****Pyetja 15 D 1 pikë****Pyetja 16 D 1 pikë****Pyetja 17 B 1 pikë****Pyetja 18 A 1 pikë****Pyetja 19 3 pikë**

- a) drejtësia njerëzore dhe ajo e Zotit.
- b) kundërshtie.
- c) antonim.

Pyetja 20 1 pikë

Ai ka dëshirë të shohë Marinë.

- **1 pikë**, kur gjen dëshirën.
- **0 pikë**, kur e gjen gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 21 **4 pikë**

* nxënësi do të shkruajë katër fjali.

* fjalitë do të jenë fjali të thjeshta.

* fjalitë do të vlerësohen sipas formulimit personal të çdo nxënësi, mjafton që secili formulim të përmbajjë kuptimin(thelbin) kryesor të secilit paragraf :

- paragrafi 1: prifti i zbulon Mersosë raportin mes drejtësive.
- paragrafi 2: prifti i kërkon Mersosë të shohë një fytyrë të shenjtë.
- paragrafi 3: Merso shikon dhe imagjinon fytyrën e Marisë.
- paragrafi 4: Merso ëndërron lirinë, jetën, natyrën etj, duke i lidhur dhe me zgjedhjet e mamasë.

- **4 pikë**, nëse shkruan katër fjalitë si më lart.
- **3 pikë**, nëse shkruan tre nga fjalitë si më lart.
- **2 pikë**, nëse shkruan dy nga fjalitë si më lart.
- **1 pikë**, nëse shkruan një fjali si më lart.
- **0 pikë**, nëse nuk shkruan asnjë fjali ose shkruan fjali të cilat nuk i përgjigjen kërkesave më lart.

Pyetja 22 **3 pikë**

a) sepse është indiferent, i nënshtruar, i dobët, i destinuar (ngjarjet nuk varen nga ai).

b) keqardhje, dhimbje...dhe cdo përgjigje që jep ndjesinë personale të nxënësit.

c) arabi, mamaja.

- **3 pikë**, nëse jep tre përgjigjet e dhëna më lart.
- **2 pikë**, nëse jep dy nga përgjigjet e dhëna më lart.
- **1 pikë**, nëse jep një nga përgjigjet më lart.
- **0 pikë**, nëse nuk jep asnjërën nga përgjigjet më lart ose jep përgjigje që nuk përputhen me pyetjen dhe fragmentin.

Pyetja 23 **3 pikë**

Përgjigja duhet të ketë parasysh që thënia i referohet humanizmit të Kamysë, vlerësimin që ai ka për njeriun.

Përgjigja mund të jetë po ose jo. Nxënësi duhet ta argumentojë atë me referime nga vepra ose fragmenti.

- **3 pikë**, nëse nxënësi jep humanizmin dhe argumenton nëse kjo gjë duket te Merso.
- **2 pikë**, nëse gjen humanizmin dhe thotë po, jo pa argumentuar.
- **1 pikë**, nëse gjen vetëm humanizmin.
- **0 pikë**, nëse nuk i përgjigjet drejt pyetjes ose nuk jep asnjë përgjigje.

Pyetja 24 **3 pikë**

a) sinjali është sirena. (ulërinë sirenat).

b) në fragment thuhet: ...*ulërinë sirenat. Ato më njoftonin nisjen për në botën tjetër.* Ai nuk është më indiferent, sepse ndjente fundin, ndjente që ishte i pashmangshëm, ndjente që nuk do të shihte më Marinë, natyrën, jetën, lirinë, që jepen aq bukur në fragment Pranohet çdo mënyrë tjetër shpjegimi por që ndërtohet mbi faktet që jepen në paragrafin e fundit.

c) Këtu do të pranohen fjalë dhe shprehje që mbajnë peshë në zhdukjen e indiferencës si: paqe e mrekullueshme, mendova për mamanë, ai u ndje gati për të jetuar përsëri, po i hapësja indiferencës së butë të kësaj bote, vërshim i papërmbajtshëm, etj. Pranohen fjalë dhe shprehje të tjera nga paragrafi i fundit, të cilat janë thelbësore për atë që kërkohet në pyetje. P.sh, nëse nxënësi gjen fjalën *i dërrmuar* kjo nuk na thotë që Merso nuk është më indiferent, por nëse thotë; u ndjeva gati për të jetuar përsëri, këtu kemi zgjimin e dëshirës së Mersosë për jetën. Po kështu, kur themi, *mendova për mamanë*, kuptojmë që ai nuk është më indiferent ndaj vdekjes së saj.

- **3 pikë**, nëse nxënësi u përgjigjet tri pikave.
- **2 pikë**, kur jep dy prej tyre.
- **1 pikë**, kur jep njërin prej tyre.
- **0 pikë**, nëse nxënësi nuk jep asnjërin nga përgjigjet. ose i referohet komenteve dhe shembujve që nuk kanë të bëjnë me pyetjen.

Pyetja 25 **3 pikë**

Po rendisim disa tipare të stilit të Kamysë. Më pas jepet një model përgjigjeje. Nxënësi duhet të japë një tipar, ta shpjegojë funksionin në fragment të tiparit, duke e konkretizuar me shembull. Do të pranohen si pozitive të gjitha përgjigjet që japin një nga tiparet më poshtë , me shpjegim dhe shembull brenda fragmentit.

***Tipare të stilit të Kamysë janë:**

- rrëfimi i ngjeshur, konçiz, i theshtë, i drejtpërdrejtë, në vetën e parë.
- stili neutral, transparent.
- rrëfimi i mbështetur në episode kyçe.
- stili i zhveshur.
- prania e absurdit në situatë, veprime, gjendje.
- prania e fatalitetit, tragjizmi.
- trajtimi i koncepteve të tilla si: kufizimi i lirisë, vetmia, frika, nënshtrimi, pajtimi me gjendjen.

*** Model përgjigjeje:**

- a) një tipar i stilit është rrëfimi në vetën e parë.
- b) kjo bën që autori të ndikojë drejtpërdrejt te lexuesi, sepse tregon vetë Merso.
- c) kjo duket në momentin kur ai përshkruan dëshirën për të jetuar në paragrafin e fundit.
...*po i hapësja për herë të parë indiferencës së butë të kësaj bote.*

- **3 pikë**, nëse jep tiparin, shpjegimin dhe shembullin nga fragmenti.
- **2 pikë**, nëse jep dy prej tyre.
- **1 pikë**, nëse jep njërin prej tyre.
- **0 pikë**, nëse nuk jep asnjërin, ose jep përgjigje të gabuar.